Rama e lidh fatin e tij politik me projektin e Zvërnecit

Sipas Kryeministrit investimi do të vijojë edhe nëse hetimet e SPAK-ut do të vërtetojnë tjetërsim të pronave të lidhura me projektin e një resorti turistik, i prezantuar si ide e dhëndrit të presidentit të SHBA-së, Jared Kushner.

nga **Blerina Gjoka** — 3 hours më parë në **Artikull kryesor**, **Lajme** Koha e leximit: 2 min lexim

AA 0

Ndaj në Facebook Ndaj në Twitter

Edi Rama në konferencë për shtyp | Foto: LSA

Kryeministri Edi Rama tha të martën se nuk do të tërhiqej nga projekti turistik i parashikuar në zonën e mbrojtur të Zvërnecit, Vlorë, pavarësisht protestave qytetare kundër këtij projekti dhe një hetimi të nisur për tjetërsim pronash nga eksponentë të krimit të organizuar në gjurmën e këtij projekti.

"S'ka asnjë shans që investimi të ndalojë sa kohë unë do të jem këtu"- tha Rama duke e lidhur të ardhmen e tij politike me fatin e projektin të një resorti turistik, i prezantuar publikisht si një ide e dhëndrit të presidentit të SHBA-së, Jared Kushner.

Madje ai tha se investimi nuk do të ndalet as nëse hetimet e nisura nga Prokuroria e Posaçme, SPAK, do të dalin në përfundimin se ka patur përfitim të paligjshëm të tokave ku do të ndërtohet projekti i kontestuar.

"Investimi vazhdon me pronarët e rinj dhe të ligjshëm dhe në rast se nxjerr një tjetër origjinë prone, ata që kanë të drejtën e asaj prone, mund të marrin ato para dhe të gjitha janë të lumtura përveç palës që ka mashtruar"- tha ai.

Po ashtu Kryeministri komentoi vendimin e prokurorisë për bllokimin e llogarive bankare të një prej kompanive të lidhura me zhvillimin e këtij investimi dhe që zotërohet nga dy vëllezër miliarderë nga Katari.

Sipas tij bllokimi i transaksionit 'është arbitrar dhe negativ', ndërsa "bllokimi i kalimit të parave te pronari që ka dyshime është i mirëpritur", ndërsa doli garant për reputacionin dhe seriozitetin e tyre dhe për ligjshmërinë e burimeve financiare.

Prokuroria e Posaçme, SPAK, konfirmoi të hënën se ka nisur hetimi mbi mënyrën e përfitimit të tokave në zonën e mbrojtur të Zvërnecit nga një rrjet i dyshimtë individësh dhe kompanish, si edhe mbi procedurat e zbatimit të projektit për ndërtimin e resorteve turistike.

Kompania që po zhvillon resortin, Zvërnec South Adriatic Development, është regjistruar offshore në formën e një trusti në Holandë, ndërsa pronarët përfitues të saj mbeten anonimë.

Por një investigim i BIRN i publikuar të premten e kaluar, gjeti se pas projektit për ndërtimin e rezorteve, që është prezantuar publikisht si një ide e dhëndrit të presidentit të SHBA-së, Jared Kushner, fshihet një rrjet vendor i dyshimtë individësh dhe kompanish.

Aty përfshihen: një biznesmen i akuzuar për lidhje me mafian italiane, një ish-gjyqtar i dorëhequr për shkak të procesit të vetingut, vajza e një avokati të akuzuar për falsifikim, kompania e një biznesmeni të vrarë dhe individë të lidhur me një prej oligarkëve më të mëdhenj në Shqipëri, Shefqet Kastrati.

Merrini lajmet tona me email!

Abonohu

Apeli heq apartamentin e Ergys Agasit nga sekuestroja

17:19 | 02/06/2026

Grupimi i Partive Ambjentaliste Europiane kundër resortit të 'Kushner' në Zvërnec

16:52 | 02/06/2026

Komiteti Shqiptar i Helsinkit thirrje për hetim të plotë të protestës së Zvërnecit

15:20 | 02/06/2026

Rama e lidh fatin e tij politik me projektin e Zvërnecit

14:37 | 02/06/2026

Protesta e parë shqiptare kundër neoliberalizmit

08:54 | 02/06/2026

Gjykata Kushtetuese rrëzon kërkesën për komision hetimor të çështjes "McGonigal"

07:54 | 02/06/2026

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni
Rreth nesh
Stafi
Kontaktoni
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by Sfida.PRO